

UDHËZIM PËR LIRIM NGA PROVIMET

Lirimi nga provimi P3/Kontabilisti në biznes

Nëse jeni të regjistruar në SHKÇAK dhe keni kualifikime akademike (apo jeni në proces e sipër) ju mund të bëni kërkesë për lirim nga provimi P3/ Kontabilisti në biznes.

Kur do të merret në konsiderim aplikacioni/kërkesa për lirim nga provimi?

Nëse keni kualifikim (apo jeni në proces e sipër) nga institucionet të cilat janë të miratuara nga SHKÇAK dhe nëse dëshmoni që e keni kryer provimin që është konform me kurrikulumin e lëndës P3/ Kontabilisti në biznes të SHKÇAK ju duhet të dorëzoni:

- Çertifikatën origjinale akademike të notave (të vulosur dhe nënshkruar)

Të drejtë për të aplikuar për lirim nga provimi kanë studentët të cilët e kanë të përfunduar provimin relevant në Universiteti i Prishtinës apo ndonjë Universitet tjetër të licencuar nga ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Lista e provimeve:

- Organizimi i ndërmarrjes
- Organizimi afarist
- Bazat e Menaxhmentit
- Menaxhmenti strategjik
- Menaxhmenti i resurseve humane
- Ndërmarrsija
- Organizimi i punës
- Menaxhimi i sjelljes organizative
- Bazat e Biznesit
- Menaxhimi i organizatës
- Menaxhment dhe organizim
- Hyrje në biznes

Dëshmitë duhet të jenë në gjuhën shqipe apo gjuhën angleze.

Nuk do të merren në konsiderim aplikacionet për lirim nga provimet të cilat nuk janë të akredituara nga SHKÇAK.

Informatat e dhëna në aplikacion/kërkesë për lirim nga provimi do të verifikohen dhe aplikuesit do të njoftohen nëse janë apo jo të liruar nga provimi.

Studentët të cilët do të lirohen nga provimi do të paguajnë shumën e cila është e njëjtë me shumën që paguhet për një provim sipas plan programit.

Provimet tjera të akredituara nga SHKÇAK

Disa nga provimet nga Association of Chartered Certified Accountants – ACCA janë në pajtueshmëri me programin e SHKÇAK prandaj kandidatët që kanë përfunduar disa ose të gjitha provimet e ACCA mund të aplikojnë për lirim nga ato provime.